



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 842/4 Prot.

Tiranë, më 23. 09. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 248, Datë 23 /09/ 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 117 Regj, datë 30.05.2024, paraqitur nga ankuesi O.M (në vijim ankuesi), kundër Komisionit të Apelit, Universiteti i Tiranës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesi O.M , në mes të tjerash informon se: “Në datën 21 qershor 2024 në Universitetin e Tiranës do të zhvillohen zgjedhjet për Senatin Akademik, i cili është organi më i lartë vendimarrës për UT. Senati përbëhet nga studentë dhe pedagogë. Për tu bërë pjesë si student, kërkohet mbështetja e 100 studentëve (lista duhet të përmbajë emër, mbiemër, fakultetin, nr.personal dhe firmën).

Një nga mbështetësit e mi e ka shkruar në mënyrë që nuk kuptohet emrin, për shkak se sapo kishte dal nga provimi, ndërkohë që të dhënat e tjera janë të sakta, përfshi këtu edhe nr personal. Kjo ka shërbyer si pretekst që unë të skualifikohem nga gara. Verifikimi i emrave është bërë nga sekretaria e Fakultetit të Ekonomisë dhe i është përcjellë Komisionit Institucional Zgjedhor UT. KIZ UT ka marrë vendimin nr.54, datë 20.05.2024, me anë të të cilit më skualifikon nga pjesmarrja, sepse kam 99 mbështetës nga 100 mbështetësit e kërkuar.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

*Për të ankimuar vendimin i jam drejtuar Komisionit të Apelit, por KA nuk ka bërë asnjë verifikim dhe ka lënë në fuqi vendimin e KIZ. Gjithashtu posedoj dokumentacion të verifikimit të mbështetësve të kandidatëve të tjerë, ku në të paktën një rast mungojnë të dhëna si mbiemri apo fakulteti.*

*Sekretaria mësimore e Fakultetit të Ekonomisë ka bërë verifikimin e mbështetësve për kandidatët: a. K.S , për të cilën mungon përcaktimi i fakultetit për studentët mbështetës (në kundërshtim me Rregulloren për Zgjedhjet në UT, neni 22, pika 2); b. D.M , në listën e të cilit mbështetësi me numër rendor 87 nuk është i lexueshëm dhe mbështetësi me numër rendor 117 nuk është i lexueshëm, gjithashtu mbështetësit me numër rendor 88 deri në 91 janë shkruar nga një person i vetëm, gjë që mund të verifikohet me sy të lirë (për shkronjën e të emri dhe për nr 7 të nr personal); c. H.K , për të cilën mungon përcaktimi i fakultetit për studentët mbështetës (në kundërshtim me Rregulloren për Zgjedhjet në UT, neni 22, pika 2).*

*Pavarësisht problemeve të sipërpërmendura, mendoj se me porosi të Zv. Dekanes për anën mësimore E.B , njëkohësisht pjesë e Këshillit Bashkiak Tiranë, e zgjedhur nga lista e Partisë Socialiste të Shqipërisë, është bërë shkëlja për të favorizuar kandidatët e mësipërm. Kandidatët K. dhe S. kanë lidhje të faktuara me strukturat e FRESH Tiranë. Gjithashtu dua të shtoj që unë, O.I M po penalizohem pasi nuk kam bindje politike dhe nuk bëj pjesë në strukturat partiake të asnjë partie politike. Ky qëndrim ka bërë që unë të cilësohem si kundërshtar i PS, pasi kam kundërshtuar përpjekjet e FRESH Tiranë për të kapur të gjitha organet përfaqësuese të studentëve.*

*Verifikimi për kandidatët e tjerë është bërë preferencial, në bazë të njohjeve personale të kandidatëve ose prapavijës politike që ata kanë. Verifikimet për studentët e tjerë janë bërë në disa raste në bazë të numrit personal, por kjo metodë nuk është përdorur për të verifikuar rastin tim. Gjithashtu, në rastin e ankimit tim, Komisioni i Apelit nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga unë dhe nuk ka bërë asnjë verifikim. ”*

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri rishqyrtimin e kërkesës që ka bërë në Komisionin e Apelit UT.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtëpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të “bindjes politike”, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.842/1 prot, datë 03.06.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Universiteti i Tiranës (UT) dhe nga Komisioni i Apelimit, në UT.
2. Me shkresën nr.1693/1 prot datë 12.06.2024, UT, ka kthyer përgjigje, duke parashtruar:

Në vendimin e Komisionit të Apelimit është përcaktuar shkaku i mosaprovimit të kandidaturës së tij për anëtar të senatit Akademik të UT-së, pasi nuk plotësonte kriterin për mbështetjen nga 100 studentë. Ky kriter është i përcaktuar në nenin 23 të Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Tiranës*”<sup>3</sup>. Për këtë arsye, gjykojmë se përcaktimi apo interpretimi i këtij kriteri, përpos faktit që është atribut ekskluziv i organeve përkatëse që janë ngarkuar për organizimin e zgjedhjeve të autoriteteve drejtuese në UT, nuk ka asnjë lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqe të “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Lidhur me pretendimin e z.O.M , Universiteti i Tiranës bazuar në nenin 8, pika 9, të Statutit të UT-së ushtron aktivitetin e tij si një institucion laik dhe i depolitizuar. Për rrjedhojë, edhe zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës, janë të depozitizuara.

Vlen të theksojmë se, në nenin 37, pikat 8, 9, 10 të rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*” është parashikuar e drejta e Komisionit të Apelimit për të shqyrtuar dhe marrë vendime, në të cilën përfshihen dhe ankimet ndaj vendimeve të marra prej KIZ-it.

Në kushtet kur, vendimi i Komisionit të Apelimit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyrueshëm për t’u zbatuar<sup>4</sup>, nuk mund të kryhet rishikimi i tij në rrugë administrative, por personi i interesuar, në rastin konkret z.O.M , mund të paraqesë ankim në rrugë gjyqësore ndaj vendimit, sikurse është cituar edhe në pikën 4, të vendimit të Komisionit të Apelimit.

Për sa më lart, duke marrë në konsideratë garancitë e përcaktuara në nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës, mbi parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të drejtën për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, gjykojmë se vendimarrjet e institucioneve të lartpërmendura janë në përputhje me këto garanci

<sup>3</sup> Miratuar me Vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT-së.

<sup>4</sup> Neni 37 pika 9 e Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Tiranës*”.

kushtetuese, kuadrin ligjor në fuqi, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e zgjedhjeve të autoriteteve drejtuese në Universitetin e Tiranës.

3. Me shkresën e datës 13.06.2024 (administruar pranë Komisionerit me nr. 842/3 prot datë 14.06.2024), Komisioni i Apelimit, përfaqësuar nga Kryetarja Prof.asoc.Dr. S.P , ka kthyer përgjigje duke parashtruar:

Pretendimi i z.O.M se në vendimin r. 8, datë 26.05.2024, të Komisionit të Apelimit, UT, është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe për çdo shkak tjetër, është tërësisht i pabazuar në prova, fakte dhe argumenta.

Z.O.M , bazuar në nenin 37, pika 8, të Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, ka paraqitur pranë Komisionit të Apelimit, UT një ankim kundër vendimit nr.54, datë 20.05.2024 të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), UT, vendim i cili nuk miraton kandidaturën e z.M. për anëtar të senatit akademik të UT-së përfaqësues të studentëve për shkak të mosplotësimit të kriterit të parashikuar për mbështetjen nga 100 studentë.

Komisioni i Apelimit, UT, mori në shqyrtim ankimin e z.O.M së bashku me dokumentacionin bashkëngjitur këtij ankimi dhe linqet e internetit.

Bazuar në nenin 23, pika 2/d të Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë: “*d) propozimin nga jo më pak se 100 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në këtë rregullore, të cilën krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.*”

Bashkëngjitur ankimit, z.O.M ka, vërtetimet e lëshuara nga Fakulteti i Ekonomisë, që provojnë se Xh.D , M.Sh dhe A.M janë studente pranë FEUT si dhe kopje të dokumentit të identifikimit për këto tre student.

Në dokumentacionin që i është vënë në dispozicion KA të UT-së, nga ana e KIZ të UT-së, konstatohet:

- Në listën emërore të studentëve mbështetës numri rendor 17, rezulton pa nr.personal identifikimi, çka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 23, pika 2/d të Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT.
- Në listën emërore të studentëve mbështetës numri rendor 88, konkretisht znj.A.M, nuk rezulton të jetë student pranë FEUT.

Komisioni i Apelimit, bazuar në arsyetimin e mësipërm si dhe në listën emërore të studentëve mbështetës për z.O.M , konstaton se ky kriter nuk plotësohet, pasi kandidati rezulton me 99 mbështetës nga 100 që parashikon neni 23, pika 2/d e Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për*

*autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Apelit, me vendimin nr.8, datë 26.05.2024 të tij ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.54, datë 20.05.2024, të KIZ, të UT-së.

Ankuesi pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjeve politike, por pa specifikuar dhe pa argumentuar cilat bindje politike dhe pa depozituar prova, të cilat faktojnë bindjen politike.

Për të vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë, argumentojmë se bazuar në nenin 30, pika 3 të Statutit të Universitetit të Tiranës “.....Mund të jenë përfaqësues të studentëve vetëm ata shtetas që janë student në Universitetin e Tiranës në çastin e zgjedhjes së tyre....”, dhe bazuar në nenin 18, pika 8, e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT “Kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik në UT, përfaqësues të studentëve, i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Kandidatët duhet të kenë mesataren mbi 8 (tetë) të provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.....”.

Gjithashtu, neni 23, pika 2 e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT parashikon dokumentacionin e kandidimit për studentët.

Nisur nga gjithçka u parashikua më lart:

*Së pari*, asnjë nga kriteret ligjore të sipërcituara nuk përmendet dhe as nuk kërkohet përkatësia, bindja, mendimi, gjykimi apo opinion politik/partiak i kandidatëve për student për anëtarë të senatit Akademik.

*Së dyti*, dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar sipas kriterëve ligjore pranë KIZ nga ana e kandidatëve student për anëtarë të senatit Akademik, bëhet fizikisht dhe në asnjë rast nuk kërkohet realizimi i ndonjë interviste apo pyetësori me gojë nga kandidatët, në mënyrë që të mund të lindin dyshime të arsyeshme për shfaqjen e bindjeve politike.

*Së treti*, kandidatët për student për anëtarë të Senatit Akademik vijnë nga të 7-ta (shtata) njësitë përbërëse të Universitetit të Tiranës, ndërkohë që KIZ dhe KAZ përbëhet nga anëtarë që vijnë nga të gjitha njësitë përbërëse të UT-së, çka do të thotë se anëtarët e këtyre Komisioneve nuk kanë asnjë mundësi objektive për t’i njohur personalisht kandidatët dhe jo më bindjet e tyre politike.

*Së fundi*, çdo vendim i marrë nga ana e Komisionit të Apelit UT, është bërë dhe bëhet vetëm bazuar në kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga ana e ankuesit në momentin e paraqitjes së ankimit.

Informacioni mbi procedurën e ndjekur në lidhje me procesin zgjedhjeve për Senatin Akademik, UT, sa i përket përfaqësueshve të studentëve në këtë organ, numrin e studentëve kandidatë, kandidaturat e miratuara dhe ato të pamiratuara, nuk është i disponueshëm nga ana e Komisionit të Apelit të

Zgjedhjeve të UT-së, pasi në bazë të nenit 6, pika 2, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, organizimi, zhvillimi, drejtimi dhe kontrolli i gjithë procesit zgjedhor, përfshirë këtu edhe regjistrimin për kandidatë të Senatit Akademik nuk është në kompetencat e Komisionit të Apelimit të Zgjedhjeve, por është në kompetencat e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ). Gjithashtu, në nenin 17, po të kësaj rregulloreje përcaktohet qartë autoriteti përgjegjës për regjistrimin e kandidatëve, është KIZ. Referuar nenit 37, pika 8, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, Komisioni i Apelimit UT ka në kompetencë të tij shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve të arsyetura për çdo ankim dhe vendim të marrë prej KIZ UT.

Komisioni i Apelimit të Zgjedhjeve, Universiteti i Tiranës, nuk disponon ndonjë dhe praktika të kandidimit të kandidatëve, përveç atyre të cilët kanë parqitur ankim për vendime të marra prej KIZ, siç është edhe rasti i z.O.M .

Komisioni i Apelimit të UT, nuk disponon procesverbal të mbledhjes së datës 20.05.2024 të KIZ, pasi vendimi nr.51, datë 20.05.2024 I KIZ UT është marrë me shumicë absolute të anëtarëve të saj dhe gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Komisionit të Apelimit nuk është arsyetuar e nevojshme kërkimi i procesverbaleve të KIZ, UT, pasi bashkëlidhur ankimit kanë qenë të gjitha dokumentet e parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore për vendimarrje të bazuar.

Në lidhje me aktet përkatëse mbi bazën e të cilave është ngritur KIZ UT dhe çdo strukturë tjetër e përfshirë në procesin e zgjedhjeve, kjo është përtej kompetencave të Komisionit të Apelimit UT. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare të *web-it* të Universitetit të Tiranës: [www.unitir.edu.al](http://www.unitir.edu.al).

4. Me *e-mailin* e datës 18.06.2024, ankuesit iu komunikuan parashtrimet dhe aktet e depozituara nga UT dhe KAZ, UT. Ankuesi nuk depozitoi prapësime në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga këto subjekte.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi O.M , është student i vitit të dytë, në ciklin e parë të studimeve në Bachelor në “Financë”, pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Ankuesi është regjistruar pranë Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, për të kandiduar për funksionin e anëtarit të Senatit Akademik, në UT, nga përfaqësuesit e studentëve.

Me vendimin nr.54, datë 20.05.2024 “Për mosmiratimin e kandidaturës së z.O.M , për anëtar të Senatit Akademik, të UT-së, përfaqësues të studentëve”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, UT, ka vendosur: *“1. Mospranimin e kandidaturës së z.O.M , për anëtar të Senatit Akademik, të UT-së, përfaqësues të studentëve, për shkak të mosplotësimit të kriterit , për mbështetjen nga 100 studentë.....”*. Kundër këtij vendimi ankuesi ka paraqitur ankim në Komisionin e Apelit, UT-së, duke pretenduar se kriteri është plotësuar por gabimi është bërë gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit nga ana e sekretarisë së Fakultetit të Ekonomisë.

Komisioni i Apelit, UT, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga ankuesi, me vendimin nr.8, datë 26.05.2024, ka vendosur: *“1. Lënien në fuqi të vendimit nr.54, datë 20.05.2024, të KIZ, të UT-së. 2. Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.....4. Kundër vendimeve të Komisionit të Apelit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.”*

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr.117, datë 30.05.2024, kundër Komisionit të Apelit, të UT-së, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”. Ankuesi pretendon se, verifikimi i kandidatëve të tjerë është bërë preferencial, në bazë të njohjeve personale të kandidatëve ose prapavijës politike që këta kandidatë kanë. Sipas ankuesit verifikimet për studentët e tjerë janë bërë në disa raste në bazë të numrit personal, por kjo metodë nuk është përdorur për të verifikuar rastin e tij dhe se Komisioni i Apelit, të UT-së, në rastin e ankimit të paraqitur nga ana e tij, nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion prej ankuesit dhe nuk ka bërë asnjë verifikim.

Rregullat dhe procedurat për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UT, përcaktohen në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, miratuar me vendimin nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT (në vijim Rregullorja).

Në nenin 23 “Dokumentacioni për kandidim”, pika 2/d, të Rregullores përcaktohet: *“2. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë: .....d) propozimin nga jo më pak se 100 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në këtë rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.”*

Rezulton se, shkak i mospranimit të kandidaturës së ankuesit, për anëtar të senatit Akademik të UT-së, si përfaqësues i studentëve, është mosplotësimi i kriterit për mbështetjen e 100 studentëve, kriteri i detyrueshëm për vlerfshmërinë e kandidaturës së studentëve për anëtarë në Senatit Akademik, i përcaktuar në nenin 23, pika 2/d të Rregullore.

Nga aktet e administratura rezulton se, në kuadër të procesit zgjedhor për anëtar në Senatit Akademik të UTS, si përfaqësues i studentëve, ai ka depozituar një listë me 101 studentë mbështetës të kandidaturës së tij. Nga verifikimi i kësaj liste, konstatohet se:

- Numri rendor 17 në këtë listë ka të shënuar emër mbiemër, fakultetin dhe nënshkrimin, por mundon numri personal.
- Numri rendor 88 në listë ka gjeneralitetet A.M , në kolonën që tregon fakultetin përkatës ka shënimin “FE” , ka të shënuar numrin personal dhe nënshkrimin.
- Numri rendor 72 në listë i përket Xh.D , ka të shënuar numrin personal dhe nënshkrimin dhe në kolonën që tregon fakultetin përkatës ka shënimin “F-Ang 2”.
- Numri rendor 73 në listë i përket Maria Shtoj, ka të shënuar numrin personal dhe nënshkrimin dhe në kolonën që tregon fakultetin përkatës ka shënimin “F-Ang 1”.

Gjatë verifikimeve të realizuara nga Komisionet e Zgjedhjeve pranë fakultetve përkatëse të UT-së, në lidhje me verifikimin e listave të mbështetësve të kandidatëve nga trupa studentore për anëtar të Senatit Akademik, ka rezultuar:

- Sipas *e-mailit datë 20.05.2024*, të dërguar nga sekretarja e Komisionit të Zgjedhjeve, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në UT, pasqyrohet ndër të tjera: “.....2- Në listën e kandidatit O.M , studentët Xh.D dhe M.Sh nuk rezultojnë student të FGJU<sup>5</sup>.”
- Sipas *e-mailit datë 20.05.2024*, të dërguar nga Komisioni i Zgjedhjeve, Fakulteti i Drejtësisë, në UT, pasqyrohet ndër të tjera: “.....7. O.M studentët mbështetës nga FD janë student të FD<sup>6</sup>.”
- Sipas një shënimi (pa datë) të lëshuar për O.M , pasqyrohet si vijon: “Nga studentët e deklaruar si FE, nuk rezulton A.M , e vijëzuar me ngjyrë”.

Vlerësimi i këtij kriteri i bërë nga ana e KIZ me vendimin nr.54, datë 20.05.2024, është vlerësuar i drejtë dhe i bazuar edhe nga Komisioni i Apelit të UT-së, me anë të vendimit nr. 8, datë 26.05.2024. Por, nëse referuar vendimit nr.54, datë 20.05.2024 të KIZ, nuk ka asnjë arsytim konkret se përse ankuesi nuk e ka plotësuar kriterin e mbështetjes nga ana e 100 studentëve, në vendimin nr. 8, datë 26.05.2024, i cili është marrë pas ankimit të ankuesit kundër vendimit të KIZ, pasqyrohet se, ankuesi nuk plotëson kriterin, pasi rezulton me 99 mbështetës nga 100 që parashikohet në nenin 23, pika 2/d të Rregullores. Në vendimin e tij Komisioni i Apelit, UT-së arsyeton se, bashkëngjitur ankimit, ankuesi ka depozituar vërtetimet e lëshuara nga Fakulteti i Ekonomisë, që provojnë se Xh.D, M.Sh dhe A.M , janë student pranë FEUT si dhe kopje të dokumentit të identifikimit për këto tre student.

Komisioni i Apelit, ka arsyetuar se, në listën emërore të studentëve mbështetës për ankuesin numri rendor 17, rezulton pa numër personal identifikimi, çka nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga neni 23, pika 2/d e Rregullores dhe numri rendor 88, konkretisht znj.A.M , nuk rezulton të jetë student pranë FEUT<sup>7</sup> dhe ka vlerësuar dhe konstatuar se ankuesi nuk plotëson kriterin e parashikuar nga neni 23, pika 2/d e Rregullores, pasi nga 100 studentë mbështetës që kërkohet nga kjo disppzitë, ai ka 99 studentë mbështetës.

<sup>5</sup> Shkurtesë për Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

<sup>6</sup> Shkurtesë për Fakulteti i Drejtësisë.

<sup>7</sup> Shkurtesë për: Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës.



Sa më sipër, rezulton e provuar nga aktet e administruara në dosje, konstatohet se nga ana e Komisionit të Apelimit të UT, janë marrë parasysh vërtetimet e depozituara nga ankuesi që provojë se Xh.D dhe M.Sh, janë studente në Fakultetin Ekonomik (FE), pjesë e trupës zgjedhore të UT, të cilat nga verifikimi i bërë nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJU, sipas shënimit të vendosur në listën rendore të mbështetësve, nuk kishin rezultuar student të këtij fakulteti.

Në lidhje me numrin rendor 17, vlerësimi i bërë nga Komisioni i Apelimit të UT-së, rezulton në përputhje me parashimet e nenit 23, pika 2/d të Rregullores, pasi mungon numri personal. Në lidhje me vlefshmërinë e mbështjes nga numri rendor 17, ankuesi nuk ngre kundërshtime në lidhje me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Apelimit, UT.

Nga aktet e administruara rezulton se, numri rëndor 88, në listën e mbështetësve të ankuesit, ka të shënuar si emër dhe mbiemër “A.M ”. Nga verifikimet e kryera nga FEUT, ka rezultuar se në këtë fakultet nuk ka student me këto gjeneralitete. Gjatë shqyrtimit të ankimit para Komisionit të Apelimit, UT, ankuesi ka depozituar një vërtetim, sipas të cilit provohet se, shtetasja A.M, është studente e FEUT. Ky vërtetim është shoqëruar edhe me kartën e identitetit, fakte këto që pasqyrohen në vendimin nr.8, datë 26.05.2024, të Komisionit të Apelimit të UT-së.

Ankuesi pretendon se, Komisioni i Apelimit të UT, nuk ka kryer verifikimet përkatëse nëpërmjet numrit personal për mbështetësen me numrin rendor 88, e cila ka shënuar gabim emrin e saj në listën e mbështetësve, por ka të pasqyruar saktë në këtë listë numrin personal. Sipas ankuesit, për kandidatë të tjerë, janë kryer në mënyrë preferenciale verifikimet e mbështetësve edhe nëpërmjet numrit personal dhe se Komisioni i Apelimit nuk ka marrë parasysh dokumentacionin e depozituar nga ana e tij.

Ankuesi ka depozituar në cilësinë e provës pranë Komisionerit, një deklaratë të lëshuar në datën 28.05.2024 nga ana e shtetasës A.M , e cila deklaron ndër të tjera se: *“ për shkak të shpejtësisë, emrin e kam shënuar gabim ndaj duket jo qartë. Ngarkesa emocionale dhe stresi i provimit të asaj dite, ka qenë shkak kryesor. Deklaroj me bindjen e plotë se aty gjendet ID ime si dhe të gjitha të dhënat e tjera të sakta. E deklaroj këtë nën përgjegjësinë time personale si një mbështetëse e kandidatit për student senator O.M ..... ”*

Sikurse rezulton edhe nga data e lëshimit të deklaratës 28.05.2024, kjo deklaratë nuk ishte pjesë e dosjes së shqyrtimit pranë Komisionit të Apelimit, të UT-së, për të bërë të vërtetuar se, A.M shënuar në listën e mbështetësve me numër rendor 88, e cila nuk figuron me të drejtë studente në FEUT, ishte i njëjti person me A.M , e cila rezulton e provuar se është studente në FEUT.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në dokumentacionin e administruara nga Komisioni i Apelimit, të UT-së, në momentin e marrësjes së vendimit nr. 8, datë 26.05.2024, pavarësisht se numri personal i shënuar përmbri numrit rendor 88, me gjeneralitete të shënuara A.M në listën e studentëve mbështetës të ankuesit i korrespondon A.M , në mungesë të deklaratës së lëshuar nga kjo e fundit në datën 28.05.2024, nuk mund të vlerësonte se A.M dhe A.M , ishin i njëjti person.

Me vendimin nr.51, datë 20.05.2024 “Për shpalljen e kandidatëve për Anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve, nga kategoria e studentëve të UT-së, pranë KIZ-it, të UT-së”, KIZ, ka miratuar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatura, ku përfshihen edhe kandidatët D.M , H.K dhe K.S dhe ka vendosur mosmiratimin e 4 (katër) kandidaturave, përfshirë edhe ankuesin.

Ankuesi pretendon se, për kandidatët e tjerë D.M , K.S dhe H.K , janë bërë verifikime preferenciale, verifikimet janë bërë në disa raste në bazë të numrit personal, por kjo metodë nuk është përdorur për të verifikuar rastin e tij.

Në bazë të nenit 37 “Komisioni i Apelimit”, pika 8, të Rregullore, përcaktohet se: “8. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen edhe mendimet kundër, për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ-it.”

Sa më sipër dhe në kushtet kur kandidatët D.M , K.S dhe H.K , nuk mund të kenë ushtruar ankim kundër vendimit të KIZ-it, pasi ata janë pranuar si kandidatë, Komisioni i Apelimit të UT-së, i cili ushtron kompetencat e tij vetëm në raste ankimesi të vendimeve të KIZ, nuk ka kryer verifikime në lidhje me këta kandidatë.

Për sa i përket pretendimeve të ngritura nga ankuesi në lidhje me kryerjen e verifikimeve nga ana e sekretarisë së Fakultetit Ekonomik, Komisioneri vlerëson se ato nuk mund t’i kundërdrejtohen Komisionit të Apelimit të UT-së.

Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Komisionit të Apelimit, UT. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit O.M , për shkak të “*bindjes politike*” dhe për “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Komisionit të Apelimit, Universiteti i Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Bindje politike, çdo shkak tjetër  
Fusha: Arsim  
Lloji I vendimit: Mosdiskriminim